



Regjistri Elektronik për Njoftimet  
dhe Konsultimet Publike

## PROJEKTIGJ “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Postuar më: 08.10.2019

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, organizon **nese**, ne date **09.10.2019**, ora **09:00**, ne mjediset e **ISH ATSH-se**, degjese publike per **prezantimin dhe diskutimin** e disa ndryshimeve te propozuara ne **Ligjin per mbrojtjen e mjedisit**.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

**L I G J**

**(PROJEKT)**

\_\_\_\_ / 2019

**PËR**

**NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 10 431, DATË 09.6.2011**

**”PËR MBROJTEN E MJEDISIT”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 te Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

## **K U V E N D I**

### **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

#### **V E N D O S I:**

Ne ligjin nr. 10 431, datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

#### **Neni 1**

Pika 2 e nenit 29 ndryshon si më poshtë vijon:

“2.Dhënia e lejeve të mjedisit përcaktohet sipas një sistemi të përbërë prej dy nivelesh, mbështetur në madhësinë dhe llojin e veprimtarisë që ka nevojë të pajiset me leje, si dhe në mundësinë që ka ajo veprimtari të shkaktojë ndotje në atë masë që mund të sjellë dëm në mjedis dhe të rrezikojë shëndetin e njeriut:

- a. kategoria e veprimtarive A, për të cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit A;
- b. kategoria e veprimtarive B, për të cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit B;

Kategoritë e veprimtarive dhe kufijtë ndërmjet tri niveleve përcaktohen në ligjin për lejet e mjedisit”.

## **Neni 2**

Në pikën1 të nenit 62, fjalia “...kryhet nga inspektorati shtetëror kompetent (më poshtë “Inspektorati”,)” zëvendësohet me “...kryhet nga struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit”.

## **Neni 3**

Kudo në tekstin e ligjit togfjalëshi “A, B dhe C” zëvendësohet me “A dhe B”.

## **Neni 4**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

## KRYETARI

## GRAMOZ RUÇI

### Dokumenta:

- [Projektligji](#)

---

Diskutimet

---